



PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit
ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal
i Zi - Kosovë 2014- 2020

Prill
2020

FOTO: ZHVILLIMI I EKO-TURIZMIT NË ALPET BALLKANIKE (QENDRA PËR MBROJTJEN DHE HULUMTIMIN E ZOGJVE – MAL I ZI)

PËRMBAJTJA

Edicioni i gjashtë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

* Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

- »»» Bashkëpunimi ndërkufitar gjatë pandemisë së virusit korona (COVID 19).....2
- »»» Hyn në fuqi Udhëzimi i ri për rimbursimin e TVSH-së për OJF-të shqiptare.....2
- »»» Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri.....3
- »»» Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë.....6

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

Bashkimit Evropian
paraqet domodoshmerisht mendimet e



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE – ALB

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI – SHQIPËRI 2014-2020



MNE – KOS

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020



Bashkëpunimi ndërkufitar gjatë pandemisë së virusit korona (COVID-19)

Pandemia e virusit Korona (COVID-19) ka goditur rajonin e papërgatitur dhe si rezultat situata po ndikon në jetën tonë të përditshme, duke përfshirë edhe punën tonë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për ato projekte në zbatim me një kohëzgjatje të përcaktuar zbatimi. Sekretariati i Përbashkët Teknik i Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri dhe Mali i Zi-Kosovë (SPT) ka anuluar të gjitha evenimentet e tij publike deri sa të normalizohet situata në rajon dhe të eliminohet rreziku për shëndetin e pjesëmarrësve në këto ngjarje.

Sidoqoftë, SPT mbetet në dispozicion të aplikuesëve potencial dhe përfituesve të granteve përmes kanaleve të krijuara të komunikimit, duke marrë parasysh që i gjithë stafi i SPT-së ka punuar vazhdimisht nga shtëpitë e tyre dhe, së fundmi, nga zyrat e tyre në mënyrën e zakonshme. Në rast se keni nevojë për ndihmë ose informacion në lidhje me programet ndërkufitare, [na kontaktoni](#).




Foto: OBSH

Organizimi i punës gjatë pandemisë duhet të përshtatet me situatën në terren. Konsideroni rekomandimet e mëposhtme kur organizoni punën tuaj lidhur me zbatimin e projekteve në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar (informacione për **përfituesit e granteve**):

- Përdorni video konferenca - komunikoni me kolegët duke përdorur mjete të video komunikimit siç janë Webex, Zoom, Skype, etj. dhe koordinoni aktivitetet tuaja;
- Në vend të ngjarjeve (nëse është e aplikueshme dhe e mundshme) përqendrohuni në aktivitete "të lehta" siç janë botimet, raportet dhe raportimet, analizat, etj.;
- Organizoni internet konferenca (on-line) ose panel diskutime (nëse është e aplikueshme dhe e nevojshme);
- Nëse është e nevojshme, ndryshoni planin tuaj të veprimit sipas nevojave tuaja dhe informoni Autoritetin Kontraktues për ndryshimet;
- Nëse nuk është e mundur të përfundoni aktivitetet brenda afatit të caktuar, kërkoni zgjatjen e afatit për zbatimin e projektit;
- Përdorni këtë kohë për të promovuar aktivitetet tuaja tek audienca më e gjerë përmes mediave sociale.

Nëse jeni të interesuar të aplikoni me projekt propozim në thirrje të ardhshme për dërgimin e projekt-propozime (CFP) (ende të papublikuar)

dhe nëse jenë të përfshirë në një nga kategoritë e **aplikuesve potencial**, merrni parasysh këto rekomandime:

- Lexoni dokumentet e programeve të IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar [Mali i Zi - Shqipëri](#) dhe [Mali i Zi - Kosovë](#);
- Vizitoni dhe përdorni mjedin për të gjetur partnerët e projektit lidhur me programet [Mali i Zi - Shqipëri](#) dhe [Mali i Zi - Kosovë](#) dhe formoni partneritetin e ardhshëm;
- Mësoni rreth projekteve që janë aktualisht duke u zbatuar dhe lexoni në faqet tona të internetit Udhëzimet për Aplikues të cilët ishin për thirrjet e mëparshme për dërgimin projekt-propozimeve - www.cbc-mne-alb.org dhe www.cbc-mne-kos.org;

ME RËNDËSI: Për informacion lidhur me situatën e pandemisë në vendin tuaj, ju rekomadojmë të përdorni vetëm informacionin i cili është në dispozicion në faqet zyrtare të institucioneve shëndetësore:

- Instituti për shëndet publik i Malit të zi - <https://vvv.ijzcg.me/>
- Instituti për shëndet publik i Republikës së Shqipërisë - <http://www.ishp.gov.al/>
- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës - <http://niph-rks.org/>


Hyn në fuqi Udhëzimi i ri për rimbursimin e TVSH-së për OJF-të shqiptare

Gjatë zbatimit të projekteve të financuara nga Thirrja e Parë e IPA Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri, kishte disa pengesa në procesin e rimbursimit të TVSH-së për OJF-të shqiptare. Problemet e identifikuar gjatë zbatimit të projekteve dhe shqetësimet e shprehura të palëve të interesuara në program dhe atyre që merren me fondet IPA mundësuan nisjen e procedurës së rishikimit të rregullave për rimbursimin e TVSH-së.

Përkatesisht, Udhëzimi i ri "PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" u shpall në Gazetën Zyrtare të Republikës së Shqipërisë Nr. 169, me datë 11 dhjetor të vitit 2019. Udhëzimi mund të shkarkohet [këtu](#).

Udhëzimi prezantoi ndryshime të rëndësishme në procedurën ekzistuese. Përkatesisht, kur një organizatë jofitimprurëse (OJF) si entitet „që ka lidhur një kontratë të financuar me fonde të donatorit, pavarësisht statusit të saj në kontratë, OJF-ja gëzon të drejtën e rimbursimit të TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në kuadër të kësaj kontrate, sipas procedurës së përcaktuar në këtë udhëzim.

OJF-ja (lider/koordinatore apo bashkëpërfutuese) pjesë e kontratës së grantit me donatorin apo institucionin/entitetin e autorizuar/deleguar zyrtarisht prej tij, brenda 90 ditëve kalendarike nga data përfundimtare e pranueshmërisë së shpenzimeve, aplikon pranë



drejtorisë rajonale tatimore (DRT) përkatëse, për regjistrim për efekt rimbursimi TVSH-je, në kuadër të zbatimit të kontratës, sipas formularit 6A dhe shpjegimeve përkatëse, pjesë integrale e këtij udhëzimi.

Formulari 6A shkarkohet elektronikisht në:

- <https://www.tatime.gov.al/c/6/71/tatimi-mbi-vlerene-shtuar;>
- <https://www.tatime.gov.al/c/6/257/262/tatimi-mbi-vleren-eshtuar;>
- <https://www.tatime.gov.al/d/8/129/209/185/tatimi-mbivieren-e-shtuar.>

Pas plotësimit me të gjitha të dhënat e nevojshme, i adresohet zyrtarisht DRT-së përkatëse, duke i bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

- a) kopje të noterizuar të kontratës (marrëveshjes së partneritetit) midis OJF-së dhe donatorit apo institucionit/entitetit të autorizuar zyrtarisht prej tij për lidhjen e kontratës së financuar/ bashkëfinancuar me grant, në gjuhën në të cilën është lidhur kjo kontratë, së bashku me kopje të përkthyer në shqip dhe noterizuar;
- b) kopje të noterizuar të kontratës në gjuhën në të cilën është lidhur kontrata/marrëveshja mes liderit/koordinatorit dhe bashkëpërfutësit dhe/ose nënpërfutësit të grantit (nëse është e aplikueshme), së bashku me kopje të përkthyer në shqip dhe noterizuar;
- c) ekstrakti i OJF-së nga Gjykata (dokumentacionin që provon statusin jofitimprurës së bashku me ndryshimet që mund të ketë pësuar OJF-ja).

DRT-ja përkatëse regjistron në një regjistër të veçantë të tilla OJF për efekt të rimbursimit të TVSH-së së paguar në kuadër të kontratës së grantit dhe brenda 10 ditëve pune lëshon për OJF-në certifikatën e regjistrimit të kontratës për efekt të rimbursimit të TVSH-së, sipas formularit 6C pjesë e këtij udhëzimi ose njofton refuzimin e saj duke sqaruar edhe arsyet e këtij refuzimi. Afati i vlefshmërisë së certifikatës është nga data e lëshimit të saj nga DRT-ja përkatëse deri në 24 muaj kalendarik pas datës përfundimtare të pranueshmërisë së shpenzimeve. OJF-ja mund të bëjë kërkesë për rimbursim të TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në çdo moment brenda afatit të vlefshmërisë së certifikatës, por në çdo rast vetëm për furnizimet e marra brenda afateve të përcaktuara në kontratë për pranueshmërinë e shpenzimeve. Për të përfituar rimbursimin e TVSH-së në kuadër të zbatimit të kontratës së grantit, OJF-ja mbajtëse e certifikatës së regjistrimit të kontratës për efekt të rimbursimit të TVSH-së, i paraqet Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar në kuadër të zbatimit të kontratës së grantit, sipas formatit 6R bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë e tij, së bashku me dokumentet e mëposhtme:

- a) kopje të certifikatës së regjistrimit për efekt të rimbursimit të TVSH-së;
- b) kopje të noterizuar ose origjinalin e të gjitha faturave të blerjes të mallrave dhe shërbimeve në kuadër të zbatimit të projektit në Shqipëri dhe listën e blerjeve me TVSH të bëra nga OJF-ja në kuadër të implementimit të kontratës së grantit (pjesë e formatit 6R);
- c) vërtetim nga banka me të dhënat e sakta për çdo llogari bankare të përfshirë në kërkesën për rimbursim;
- c) vërtetimin/konfirmimin e lëshuar nga donatori ose institucioni/entiteti i autorizuar/ deleguar zyrtarisht prej tij, së bashku me raportin financiar përmbledhës, listën e detajuar të shpenzimeve, raportin e verifikimit të shpenzimeve dhe

raportin e auditit (nëse është e aplikueshme), për të gjitha shpenzimet për të cilat kërkohet rimbursimi i TVSH-së.

Brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT kryen verifikimin e dokumentacionit të paraqitur dhe procedon me rimbursimin e TVSH-së në llogarinë bankare të çdo OJF-je, të vënë në dispozicion në kërkesën për rimbursim.

Në rastin kur OJF-ja nënshkruan një kontratë me një njësi shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme që vepron si autoritet kontraktues në kuadër të zbatimit të projekteve të ndihmës IPA nën regjimin e menaxhimit indirekt apo të një marrëveshjeje tjetër specifike me donatorin që parashikon mospërdorimin e burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, TVSH-ja i rimburohet OJF-së, palë në kontratë nga autoriteti kontraktues. Në këtë rast OJF-ja nuk aplikon pranë administratës tatimore, pasi rimbursimi mbulohet nga fondi i parashikuar si kosto lokale në buxhetin e institucionit buxhetor, fusha e përgjegjësisë të të cilit mbulon sektorin e financuar apo bashkëfinancuar nga donatori.”

Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Ligjërata dhe pajisje për komunitetet lokale në Berane dhe Malësi të Madhe

Në kuadër të projektit *Ishujt e Gjellbër*, partnerët e projektit nga komuna e Beranes, VIS Albania, Bashkia Malësi e Madhe dhe CARITAS nga Mali i Zi vazhduan me një seri aktivitete në fillim të vitit 2020. Përkatësisht, fushata për ndarjen e mbeturinave të thata dhe të lagësht në koshat e planifikuar vazhdoi, kështu që në atë seri, bashkësia lokale e Dolacit ishte destinacioni i ralles ku u krye ky aktivitet, gjatë së cilit u mbajt një takim me banorët e këtij komuniteti lokal në fillim të marsit. Bashkia Berane, në bashkëpunim me ndërmarrjen publike për utilitete dhe policinë komunale, ka përgatitur një plan për shpërndarjen e një grupi të koshave të mbeturinave me një vëllim prej 120 litrash në një pjesë të Dolacit, ndërsa projekti do të përfshijë 1.000 amvisëri brenda këtyre aktiviteteve.



Për më tepër, më 26 shkurt të vitit 2020, u organizua një punëtori me Këshillin Studentor në Shkollën e Mesme Sherif Hoxha në Koplík (Malësi e Madhe).

Gjatë punëtorisë, 29 studentë u njohën me projektin dhe aktivitetet e tij dhe temat mbi qasjen në procesin e ndarjes së mbeturinave të lagura dhe të thata, si dhe rëndësinë e mbledhjes selektive të mbeturinave. Për më tepër, punëtorja kishte për qëllim të sensibilizojë mbi menaxhimin e duhur të mbeturinave, zvogëlimin, ripërdorimin dhe riciklimin dhe aktivitetet mjedisore që duhen ndërmarrë.

Për të inkurajuar angazhimin e studentëve dhe për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e zvogëlimin të mbeturinave, ripërdorimit dhe riciklimin, studentët u përfshinë në aktivitete krijuese që u bazuan në prodhimin e sendeve me materiale të ricikluar.



Aktivite ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e ruajtjes së arkitekturës tradicionale në zonat rurale

Muzeu Polimje dhe Agjencia e Zhvillimit Rajonal për Bjelasica, Komovi dhe Prokletije në Mal të Zi, dhe Këshilli Rajonal i Shkodrës dhe Euro Partners në Shqipëri, po zbatojnë bashkërisht një projekt bashkëpunimi ndërkufitar për ruajtjen e peisazheve kulturore të Malit të Zi dhe të Shqipërisë. Deri më tani, në kuadër të këtij projekti janë zbatuar aktivitete të shumta - studime dhe rekomandime për arkitekturën tradicionale në të dy anët e kufirit, modelimin e brendshëm të shtëpive rurale të angazhuar në turizëm, dizajn kulturor dhe peizazhi në 4 bashkësi, si dhe krijim e etno dhomave.



Në fund të Dhjetorit, si pjesë e një fushate për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes së arkitekturës tradicionale, u mbajt një ekspozitë në Muzeun Polimje me rreth 100 pjesëmarrës dhe një numër shumë më të madh vizitorësh gjatë Janarit të vitit 2020.

Kjo ekspozitë paraqet fotografi nga arkivat e arkitekturës lokale të Muzeut Polimje, si dhe fotografi të mbledhura gjatë realizimit të këtij projekti. Mysafirët e kësaj ekspozite ishin studentë nga shkollat fillore në Berane dhe Andrijevicë të cilët morën pjesë në një projekt arti që lidhej edhe me arkitekturën tradicionale rurale, dhe u zgjodhën dhe u ekspozuan veprat më të mira të artit. Ekspozita u hap në 20 dhjetor të vitit 2019 dhe ishte e hapur për publikun edhe gjatë janarit të vitit 2020. Kjo ngjarje u hap nga drejtoresha e Muzeut të Polimjes, zonja Violeta Foliq, dhe lektore e ftuar ishte zonja Sandra Kapetanović, një nga autorët e studimit të arkitekturës tradicionale që u bë përmes këtij projekti.

Tryezë e rumbullakët dhe seminar mbi praktikat më të mira të BE-së për mbrojtjen nga përmbytjet

Në kuadër të projektit *Fatkeqësitë nuk njohin kufijtë*, FORS Mali i Zi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Situatave Emergjente të Ministrisë së Brendshme të Malit të Zi dhe prefekturën e Shkodrës, organizuan një



tryezë të rumbullakët në Podgoricë dhe trajnim në Shkodër. Përkatesisht, në Podgoricë u organizua një tryezë e rumbullakët për praktikën më të mira të BE-së për mbrojtjen nga përmbytjet me qëllim të shkëmbimit të përvojave, modeleve të praktikave të mira dhe mësimave të marra kur bëhet fjalë për këtë rrezik natyror. Në tryezën e rumbullakët morën pjesë përfaqësues të Administratës së Situatave të Emergjencave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe shërbimet komunale për mbrojtje dhe shpëtim nga Podgorica, Tivari dhe Ulqini. Gjatë tryezës së rumbullakët, pjesëmarrësit diskutuan pajisjet për mbrojtjen dhe shpëtimin personal dhe kolektiv, shembuj të praktikës së mirë në menaxhimin e përmbytjeve dhe vlerësimin e rrezikut, si dhe Direktivën e BE-së mbi përmbytjet.




Për më tepër, para tryezës së rumbullakët, u organizua një seminar në këtë temë në Shkodër, me 11 dhe 12 shkurt, gjatë të cilit pjesëmarrësit - përfaqësues të institucioneve dhe shërbimeve të mbrojtjes dhe shpëtimit - patën mundësinë të mësojnë nga kolegët e tyre nga Shërbimi malor i Shpëtimit Korat mbi përvojat dhe modelet e praktikës së mirë në lidhje me aktivitetet që synojnë përmirësimin e mbrojtjes dhe shpëtimit nga përmbytjet.

Përkatesisht, pjesëmarrësit nga strukturat e dy vendeve fqinje, Shqipëria dhe Mali i Zi, patën mundësinë për të përditësuar dhe për të fituar njohuri në lidhje me praktikën më të mira të ekipeve të kërkimit/shpëtimit të BE-së, mbi tema të caktuara siç ishin menaxhimi i përmbytjes, situatat e planifikimit, dinamika e ujit dhe rreziqet e shfaqura prej tij, kërkim dhe shpëtim në lumenj dhe situata përmbytjeje, etj., duke përdorur materiale didaktike dhe ndihmë profesionale të trajnerëve ndërkombëtarë të Shërbimit Malor të Shpëtimit Kroat "Rescue 3", me përvojë shumë vjeçare në trajtimin e emergjencave civile dhe misionet e shpëtimit, jo vetëm në Evropë, por edhe më gjerë.



Fruta të reja në komunitetin lokal të Bushatit (Vau Dejes, Shqipëri)

Komuna e Petnjicës, Organizata e Kombëtare e Prodhuesve të Manaferrave, shkolla e mesme e Petnjicës, shkolla e mesme Profesionale "Ndre Mjeda" dhe OJF COSPE Shqipëri, si partnerë në projektin "Të Rinjtë Malazez dhe Shqiptarë për kulturën e Lule Mjedrës", organizuan aktivitete të shumta për të ndihmuar prodhuesit e rinj vendas të mjedrës në Mal të Zi dhe Shqipëri.



Rezultatet e para pas mbjelljes së mjedrës u bënë të dukshme gjatë muajit mars të vitit 2020, dhe mjedrat më në fund filluan të lulëzojnë në Bushat në komunën e Vau Dejes.



FAKTE - Mjedrat

Sipas përfituesve të granteve, mjedrat nuk janë rritur kurrë në këtë pjesë të Shqipërisë, kështu që frutat paraqesin një risi dhe një shans për përfitim dhe qëndrueshmëri të komunitetit lokal.

Promovohet „Turizmi miqësorë për fëmijët“

Shoqata për prosperitet demokratik - ZID (ADP-Zid) në kuadër të aktiviteteve të projektit *Turizmi miqësorë për fëmijët në rajonin ndërkufitar* në partneritet me Qendrën "Fëmijët Sot" (QFS) nga Shqipëria organizuan punëtorinë e tretë rajonale të mbajtur në periudhën 27-29 Janar të vitit 2020 në Podgoricë (Mal i Zi). Në seminarin e tretë ndërkufitar morën pjesë 16 pjesëmarrës nga organizata të ndryshme, duke përfshirë përfaqësues të agjencive të udhëtimit, drejtorë të etno/eko hoteleve dhe fshatrave në Mal të Zi, Parkut Kombëtar, si dhe përfaqësues të bashkisë së Lezhës dhe vendpushimeve lokale në Shqipëri. Përkatesisht, ditën e parë, pjesëmarrësve të punëtorisë iu drejtua Sanda Rakoçeviq, drejtoresha e ADP-Zid, e cila



prezantoi qëllimet e projektit dhe prezantoi ligjëruesit - Profesor **Allmir Peshtek** nga Universiteti i Sarajevës dhe Profesor **Goran Qorlluka** nga Universiteti i Splitit.



Profesori dr. Allmir Peshtek zhvilloi seancën e parë në lidhje me tendencat në turizëm, me fokus në zakonet dhe rutinat e familjes, duke theksuar rëndësinë e krijimit të qëllimeve afatgjata në vend se të përqendrohet në projekte afatshkurtra, si dhe nevojën që të punohet shumë për të ruajtur klientët ekzistues. Për më tepër, ai informoi pjesëmarrësit mbi nevojën e kyçjes së aspekteve të tregimit në procesin e krijimit të një brendi, si të bëjnë një ofertë që është tërheqëse, joshëse dhe e dukshme, si të përqendrohen në shitjen e destinacionit në tërësi, e jo vetëm një pjesë të produktit. Profesori Goran Qorlluka dha një prezantim mbi përcaktuesit dhe tendencat e kërkesës në turizëm. Për më tepër, ai shpjegoi në detaje sesi faktorë të shumtë ekonomikë, sociologjikë, psikologjikë, demografikë dhe të tjerë ndikojnë dhe

stimulojnë kërkesën turistike. Përkatësisht, gjatë pjesës së parë ai prezantoi marketingun e turizmit dhe konceptin 7P, dhe pjesa e dytë e ditës i kushtua një koncepti të përqendruar në turizëm që është i përshtatshëm për fëmijët. Pjesëmarrësve u prezantuan shembuj të ofertave ekzistuese për fëmijë në mbarë botën dhe brenda kontinentit, qëllimet kryesore të propagandës së turizmit, vlera e propagandës me komunikim gojës, si dhe pse është e rëndësishme t'u jepet turistëve më shumë sesa mund të prisnin. Në fund të seminarit rajonal, pjesëmarrësit arritën në përfundimin se turizmi miqësor për fëmijë dhe mënyra për të përmirësuar ofertën turistike ekzistuese është diçka që ka një potencial të fortë për zhvillimin e përgjithshëm të turizmit në zonën ndërkufitare.

Klikoni [këtu](#) për të ndjekur faqen në Facebook "Turizmi Miqësor për Fëmijët".

FAKTE – 7P

E ashtuquajtura përzierje e zgjeruar e marketingut apo *marketing mix* (7P) është një kombinim i shtatë elementëve të marketingut që përpiqen të punojnë së bashku për të arritur qëllimet e përcaktuara të një marketing strategjie. Këto 7 elementë janë: produkti; çmimi; promocioni; vendi; njerëzit; procesi dhe ambienti.

"Nga malet me dashuri" - panair i produkteve tradicionale malore të organizuar në ditën e Shën Valentinit në Podgoricë

Në qendrën tregtare Delta City në Podgoricë, më 14 shkurt të vitit 2020, Agjencia e Zhvillimit Rajonal për Bjelasica, Komovi dhe Prokletije dhe partnerët e projektit organizuan një panair ku prezantuan produkte të gatshme nga fermat familjare nga veriu i Malit të Zi dhe Shqipëria, si dhe kuzhinën tradicionale malore. Në këtë panair ishin rreth 60 ekspozues - prodhuesit që morën pjesë në projektin *Kuzhina lokale si ofertë turistike e rajonit ndërkufitar* - nga komuna e Pukës në Shqipëri dhe nga Mali i Zi verilindor që morën pjesë në aktivitete paketimi dhe etiketimi në kuadër të këtij projekti bashkëpunimi ndërkufitar të financuar nga BE-ja, si dhe pjesëmarrësit në një projekt të financuar nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara / Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, që është një replikim i projektit të bashkëpunimit ndërkufitar në territore të ndryshme të Malit të Zi.



Përfituesit e grantit tregojnë se "produktet



tipike malore janë të veçanta për disa arsye. Së pari, për shkak se natyra dhe biodiversiteti i këtyre zonave e kanë përcaktuar këtë listë, njerëzit nga malet korrin, kultivojnë dhe përpunojnë atë që munden në lartësi të mëdha. Paraardhësit tanë vendosën mënyrën e përpunimit të këtyre produkteve, e cila u kalua brez pas brezi deri në ditët e sotme dhe ruhet në familjet tona rurale. Këto janë produkte me shumë vlerë, të cilat paktohen dhe etiketohen siç duhet, dhe prezantohen në këtë panair për herë të parë. Në mesin e prodhuesve, disa kuzhinierë nga hotelet dhe restorantet vendas prezantuan enët speciale malore, dhe vizitorë të shumtë të panairit paten mundësinë t'i shijojnë ato. Kjo ishte gjithashtu një mundësi për të promovuar botimin "Kuzhinierin" e kuzhinës malore, i cili u botua së fundmi si pjesë e këtij projekti.

Kuzhinierin Gorska trpeza mund ta shkarkoni [këtu](#).

Reçetat nga rajoni i Pukës mund ti shkarkoni [këtu](#).

Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Pajisjet për oborrin e riciklimit të dorëzuara në Plavë dhe Gjakovë

Në kuadër të projektit të *Iniciativa të përbashkëta ndërkufitare për menaxhim më të mirë të mbeturinave* të financuar brenda Thirrjes së I-rë të Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë, pajisjet për oborrin e riciklimit iu janë dorëzuar kompanive komunale në Plavë dhe Gjakovë.



Ky projekt është duke u implementuar nga ndërmarrja e Shërbimeve komunale Plavë në Malë të Zi dhe Kompania Regjionale e Mbeturinave Çabradi – Gjakovë në Kosovë.

Rezultatet e pritura në fund të projektit do të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare përmes valorizimit më efikas të mbeturinave; krijimin e një sistemi të grumbullimit selektiv dhe trajtimit të mbeturinave komunale në zonat urbane në komunat e Gjakovës dhe Plavës; vendosjen e parakushteve teknike për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta në të dy komunat; si dhe procesin e edukimit të vazhdueshëm të aktorëve kryesorë në menaxhimin e integruar të mbeturinave komunale.



Prezantohet koncepti I2 Space

Në kuadër të projektit të zbatuar nga Asociacioni per Prosperitet Demokratik – Zid, OJQ Lens, Qendra Liberale Demokratike dhe Qendra për Aftësi Kreative, janë realizuar një numër aktivitete që synojnë promovimin e konceptit I2 SPACE. Përkatësisht, u mbajt një punëtori tre-ditore "Nga ideja në prototip" për pjesëmarrësit nga komunat e Pejës, Istogut dhe Deçanit. Pjesëmarrësit patën një mundësi unike për të mësuar se si teknologjia e informacionit vazhdon të kontribuojë në zhvillimin dhe krijimin e suksesshëm të vendeve të reja të punës. Pjesëmarrësit, me ndihmën dhe këshillën e mentorëve, hartuan prototipet e tyre të para, duke e lidhur në dobi të komunitetit risinë sociale me teknologjinë.



Për më tepër, brenda të këtij projekti, në fund të shkurtit dhe fillimit të marsit, një seri prezantimesh u organizuan në Mal të Zi në Podgoricë në

Fakultetin e Arkitekturës dhe Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Malit të Zi, dhe në Universitetin Donja Gorica, për të paraqitur konceptin I2 SPACE. Përkatësisht, themeluesit e I2 SPACE janë përqendruar në zhvillimin e bizneseve krijuese, ndërmarrjeve në fushën e turizmit, si dhe ndërmarrjeve që kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit. I2 SPACE ofron mundësinë për të testuar dhe përmirësuar njohuritë në kodim, marketing dixhital, fotografi, dizajn grafik, shtypje 3D, elektronikë dhe ofron këshillim dhe mbështetje logjistike në formën e lidhjes në fusha të ndryshme për të zhvilluar një ide të përbashkët biznesi dhe për të përdorur pajisjet dhe materialet mësimore.



FAKTE – I2 SPACE

I2 SPACE është një hapësirë inovative shoqërore, me ekspertizë në internet, në të cilën njerëzit ndajnë interesat e tyre në teknologji, punojnë në projektet e tyre dhe mësojnë nga njëri-tjetri.

Pajisjet e prokuruarra për demo fermat dhe demo fushat e vendosura

Në kuadër të projektit *Punësime në gjelbërim për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës*, partnerët e projektit zbatojnë aktivitete në komunat e Malit të Zi dhe Kosovës. Përkatësisht, në Mal të Zi, procesi i pajisjes së demo fermave dhe përfundimit të trajnimit të 25 blegtorëve të përzgjedhur në komunat Andrijevica, Berane dhe Plav është duke u zhvilluar.



Projekti u përqendrua veçanërisht në edukimin e blegtorëve përmes qendrave trajnuese, në të cilat 25 fermerë të përzgjedhur nga territori i komunave të përmendura marrin pjesë në trajnime edukative që zhvillohen në demo fermat dhe demo fushat.

Gjegjësisht, demo fermat janë vende ku fermerët mësojnë shembuj konkretë nga ekspertët e angazhuar për gjëra që janë të rëndësishme për ta në procesin e prodhimit, të tilla si p.sh. se si duhet ruajtur fondet e lopëve, si të kryhen ekzaminimet me ultratinguj për lopë, etj. Qendra e trajnimit drejtohet nga ekspertë në fushën e bujqësisë dhe mjekësisë veterinarë, së bashku me një ekip projekti i përbërë nga ekspertë të komunës Andrijevica dhe Shoqata e Fermerëve Veriorë të Malit të Zi. Për

më tepër, pasi gjysma e dytë e Marsit dhe Prillit është koha optimale për mbjelljen e misrit dhe jonxhës, gjatë këtyre muajve OJQ-ja Grupi Lokal i Veprimit "Gjeravica" vazhdoi të punojë për rritjen e aftësive teknike të fermerëve vendas. Për këtë qëllim u mbollën dy parcela, me një sipërfaqe prej 4 hektarë jonxhë dhe 3 hektarë misër në zonën rurale të Deçanit. Këto dy fusha demonstruese u përdorën për punë praktike që ishte pjesë e programit të trajnimit, dhe fushat u mbollën duke përdorur makineri të blera brenda projektit.



Gjithashtu, një seri ligjeratash u mbajtën nga gjinekologët, **Marijana Peshiq** dhe **Azra Lukaç**, në të cilat morën pjesë rreth 40 gra, përfshirë përfaqësuese të RAE popullatës, të cilat patën mundësinë për të marrë më shumë informacion mbi faktorët e rrezikut dhe masat parandaluese, siç janë ekzaminimet e rregullta gjinekologjike, rëndësia e mënyrës së sliteve të shëndetshme të jetesës dhe masave të tjera që kontribuojnë në mbrojtjen e shëndetit riprodhues.

Shënimi i javës së parandalimit të kancerit të qafës së mitrës

Në kuadër të projektit CARES - Veprimet ndër-kufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues, FORS Mali i Zi dhe ECMI Kosova kanë realizuar një numër aktivitete. Përkatësisht, pasi u përgaditen spotet promovuese në TV dhe filloi dhe mbaroi fushata e gjerë, dhe pas shënimit të Tetorit si muajit të rritjes së vetëdijes për kancerin e gjirit, projekti organizoi shënimin e Javës së Parandalimit të Kancerit të Qafës së mitrës. Java e fundit e janarit u shënuar Java Evropiane e Parandalimit të Kancerit të Qafës së Mitërës, kështu që ky aktivitet u zhvillua me qëllim të rrisë ndërgjegjësimin e grave për rëndësinë e parandalimit në procesin e mbrojtjes së shëndetit riprodhues. Ky aktivitet u reflektua në shpërndarjen e broshurave dhe materialeve promovuese, përfshirë organizimin e ekzaminimeve parandaluese në bashkëpunim me qendrat shëndetësore dhe spitalet në komunat e synuara, si dhe në ofrimin e informacionit për qytetarët përmes mediave dhe transmetimin e një spoti televiziv nën moton: Gjëje kohë. Parandalo. Jeto.



FAKTE – kanceri i qafës së mitrës

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, rreth 500.000 gra në botë dhe rreth 60.000 gra në Evropë sëmuren nga kanceri i qafës së mitrës çdo vit për shkak të njohjes së pamjaftueshme të kësaj sëmundje, masave të trajtimit dhe parandalimit.

Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike

Projekti *Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike* zbatohet nga Qendra për Mbrojtjen dhe Hulumtimin e Zogjve (CZIP), Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC), Shërbimi i shpëtimit malor të Malit të Zi dhe Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste "Pashtriku". Në kuadër të projektit Shërbimi i shpëtimit malor të Malit të Zi organizoi trajnimin e dytë për shpëtimtarët e ardhshëm në periudhën nga 9 deri në 13 mars të vitit 2020. Trajnimi i dytë i shpëtimit (kursi fillestar i alpinizmit) u organizua në Guci, dhe në trajnim morën pjesë 22 pjesëmarrës. Në cilësinë e ligjeruesëve, trajnimi është zbatuar nga ekspertët të shquar kombëtar në këtë fushë, instruktorët të Shërbimit të Shpëtimit Malor, z. Dragutin Laliq dhe z. **Mishko Kosiq**, dhe z. **Gjorgjje Vujiçiq**, instruktor alpinizmi. Për më tepër, si një shpëtimtar dhe instruktor i shquar malor z. **Zeljko Lonçoviç**, udhëheqësi i Shërbimit të Shpëtimit Malor të Malit të Zi, ndau njohuritë dhe përvojën e tij të vlefshme me pjesëmarrësit në baza vullnetare.

Trajnimi pesë-ditor u organizua në atë mënyrë që çdo ditë të përbëhej nga një seancë në mëngjes dhe një pasdite duke ndërthurur pjesën teorike me ushtrime praktike (duke përdorur kështu metodën e "të mësuarit përmes punës"). Në fillim, pjesëmarrësit u njohën me mënyrën e punës, si dhe me rëndësinë e krijimit të një ekipi shpëtimtarë në zonën e Bjeshkëve të Nemuna.



Në kuadër të projektit, është planifikuar të vendosen, përshtaten dhe shënohen shtigjet në të dy anët e kufirit në gjatësi prej së paku 25 km. Në periudhën e mëparshme të projektit, u identifikuan shqigjet (saktësisht ineniraret) në të dy anët e kufirit dhe u hartua një hartë që lidh natyrshëm të dy vendet. Kushtet e motit mundësuan fillimin e punimeve në infrastrukturën e lehtë në një pjesë të vogël të itinerarit në Kosovë, dhe punimet e mëtutjeshme në shtigje do të vazhdojnë kur situata me pandeminë ta lejojë atë llojë aktiviteti.

U organizuan punëtoritë dhe aksionet e pastrimit

Projekti *Të bashkuar kundër ndotjes – UAP*, të cilin e zbatojnë Komuna e Petnjicës, komuna e Gjakovës, OJQ Let's Do It Peja dhe Qendra për Zhvillim Rajonal – Rozhajë, vazhdojë me aktivitete në zonën ndërkufitare. Përkatësisht, për të inkurajuar komunitetin që të angazhohet më shumë në mbrojtjen e mjedisit, përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, parandalimin e rrezikut dhe menaxhimin e mbeturinave, ekipi i projektit UAP organizoi dy punëtori në dy shkolla fillore në Gjakovë. Një punëtori me temë "Rëndësia e ujit dhe mbrojtja e tij" u mbajt më 3 shkurt në shkollën fillore "Yll Morina", dhe më 4 shkurt në shkollën fillore "Zekeri Rexha", në të cilën morën pjesë 40 nxënës. Punëtorja "Tokë dhe rëndësia e saj" u organizua në 11 Mars dhe morën pjesë 20 nxënës.

Në kuadër të të njëjtit projekt, gjatë tetorit dhe nëntorit të vitit 2019, u mbajt një seri aksionesh pastrimi dhe punëtori edukative me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme në Gjakovë dhe Petnjicë. Një punëtori arsimor për problemet dhe mbrojtjen e mjedisit u organizua në komunën e Petnjicës në shkollën e komunitetit lokal Savin Bor, më 18 shkurt të vitit 2020. Gjatë kësaj punëtorie, nxënësot kishin mundësi të marrin pjesë aktive përmes lojërave interaktive dhe një libri pune të krijuar posaçërisht për këtë rast, si dhe të diskutojnë mbi çështjet mjedisore.



Shtigje të reja ndërkufitare për çiklistë

Projekti *Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës* zbatohet nga Agjencia e Zhvillimit Rajonal – Perëndimi (AZHR-Perëndim) dhe Komuna e Pejës në Kosovë dhe Agjencia Rajonale e Zhvillimit për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije dhe Organizata turistike Plavë në anën malazeze.

Gjatë muajit mars dhe prill, u krye hulumtimi i shtigjeve të reja të ngjijtëse, si dhe zhvillimi i një oferte turistike në grykën e Rugovës. Projekti synon të krijojë të paktën 300 km shtigje që do të përmbajnë itinerare të ndryshme tematike që përfshijnë monumente natyrore, vende të trashëgimisë kulturore, aktivitete rekreative dhe gastronomi tradicionale në të dy anët e kufijve të Kosovës dhe Malit të Zi, të cilat gjithashtu do të promovojnë turizëm të qëndrueshëm në rajon.



» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



European Integration Office



Ministry of finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik
E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat
E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ
E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Andi ÇEKAJ

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**
Adresa: Agim Ramadani, 36/4, 10 000 Prishtinë, Kosova
Telefon: +383 38 222 202

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian